

Treguesit e Shëndetit Publik

Viti 2021

Tiranë, më 28 Tetor 2022: Në vitin 2021, numri i vizitave gjithsej në shërbimin parësor është 8.144.504, mesatarisht 2,9 kontakte për person në vit. Numri i vizitave shënon një rritje me 10,8 %, krahasuar me numrin e vizitave në vitin 2020. Gjatë vitit 2021, ditët mesatare të qëndrimit të një patienti në spital ishin 5,1 ditë. Në institucionet publike të shërbimit spitalor janë kryer 56.622 ndërhyrje kirurgjikale, 22,1 % më shumë, krahasuar me një vit më parë.

I. Kujdesi shëndetësor parësor

Në vitin 2021, kanë operuar 413 qendra shëndetësore të degëzuara në 2.059 ambulanca dhe 46 poliklinika të specializuara. Nga 8.144.504 vizita gjithsej në shërbimin parësor, 42,8 % janë kryer në qendrat shëndetësore, 20,3 % në ambulanca dhe 37,0 % në poliklinika. Përgjatë 5 viteve të fundit, vihet re pothuasje e njëjta shpërndarje në numrin e vizitave. Mbi 40 % e vizitave në qendrat shëndetësore dhe ambulancat janë kryer nga personat mbi 60 vjeç.


Tab. 1 Aktiviteti i Qendrave Shëndetësore, Ambulancave dhe Poliklinikave

Emërtimi	Vitet				
	2017	2018	2019	2020	2021
Vizita gjithsej	7.942.742	8.219.771	7.650.504	7.353.296	8.144.504
Numri i Qendrave shëndetësore	413	413	413	413	413
Numri i vizitave në Qendra shëndetësore	3.219.003	3.411.915	3.374.429	3.149.495	3.482.174
Numri i Ambulancave	2.022	2.053	2.059	2.037	2.059
Numri i vizitave në Ambulanca	1.545.416	1.541.645	1.543.269	1.510.006	1.650.378
Numri i Poliklinikave	46	46	46	46	46
Numri i vizitave në Poliklinika	3.178.323	3.266.211	2.732.806	2.693.795	3.011.952

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Për publikim 28.10.2022

Fig. 1 Përqindja e vizitave të kryera në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor



Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Konsultori i gruas

Në vitin 2021, numri i vizitave në konsultorin e gruas është 224.790, duke shënuar një rritje me 5,8 %, krahasuar me vitin 2020. Nga totali i vizitave, 81,5 % janë vizita obsetrikale, nga të cilat 61,0 % janë realizuar me asistencë të mjekut specialist. Numri i vizitave të para obsetrikale është 25,900, ose 9,6 % më shumë, krahasuar me vitin 2020.

Tab. 2 Konsultori i Gruas

Emërtimi	Vitet				
	2017	2018	2019	2020	2021
Numri i konsultoreve	2.057	2.013	1.932	1.879	1.901
Numri i mjekëve në konsultor	765	728	753	756	760
Numri i mamive në konsultor	2.965	2.614	2.682	2.682	2689
Numri i vizitave gjithsej	272.177	243.594	206.326	212.400	224.790
Numri i vizitave gjinekologjike	45.184	46.372	38.981	30.231	41.647
Numri i vizitave obsetrikale	226.993	197.222	167.345	182.169	183.143
- me mjek	141.717	124.994	101.938	111.288	111.516
Numri i vizitave të para obsetrikale	32.787	29.517	28.178	23.636	25.900

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Konsultori i fëmijëve

Në vitin 2021, në konsultorin e fëmijëve janë regjistruar 257.054 fëmijë dhe janë kryer 745.746 vizita, mesatarisht 2,9 vizita për fëmijë në vit. Krahasuar me vitin 2020, numri i vizitave është rritur me 5,3 %. Nga totali i vizitave, 55,6 % e tyre janë realizuar me asistencë të mjekut specialist dhe pjesa tjetër janë ndjekur nga mami dhe infermierë.

Numri i fëmijëve 0-1 vjeç që ushqehen vetëm me gji gjatë vitit 2021 është 19.660, ndërkohë numri i fëmijëve që ushqehen vetëm me ushqim artificial është 4.597.

Tab. 3 Konsultori i Fëmijëve

Emërtimi	Vitet				
	2017	2018	2019	2020	2021
Numri i konsultoreve të fëmijëve	2.100	2.131	2.081	2.028	2.055
Numri i vizitave në konsultor	929.330	802.633	782.532	708.211	745.746
nga këto: sa nga mjeku	534.059	455.987	423.412	410.153	414.282
Numri i fëmijëve të regjistruar në konsultor	286.092	253.403	276.306	256.146	257.054
Numri i fëmijëve që ushqehen vetëm me gji	20.702	18.988	18.317	18.541	19.660
Numri i fëmijëve që ushqehen vetëm me ushqim artificial	5.693	5.342	4.585	4.239	4.597

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Mbulesa vaksinale është në nivelet mbi 95,0 % për shumicën e antigenëve vaksinal, duke përbushur kështu dhe kriterin bazë ku çdo antigen vaksinal duhet të jetë mbi 95,0 % në nivel kombëtar. Këtë vit vërehet një ulje e mbulesës vaksinale ndaj Difterisë, Tetanozit dhe Pertusit me 2,7 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2020.

Tab. 4 Mbulimi vaksinal, në %

Emërtimi	Vitet				
	2017	2018	2019	2020	2021
Fëmijë të vaksinuar për:					
- Tuberkuloz	99,0	99,1	98,9	97,9	98,8
- Difteri	99,0	99,8	98,6	98,5	95,8
- Tetanoz	99,0	99,8	98,6	98,5	95,8
- Pertusis	99,0	99,8	98,6	98,5	95,8
- Fruth-Rubeolë - Parotit	95,7	94,1	95,0	91,0	89,2
- Poliomit	98,9	98,7	98,6	98,3	98,0

Burimi: Instituti i Shëndetit Publik

II. Shërbimi spitalor dytësor

Në vitin 2021, numri i spitaleve publik dhe jopublik në vend është 59, nga të cilët 43 janë spitale publike dhe 16 spitale private. Mbulimi i shërbimit spitalor publik dhe jopublik është 2 spitale për 100 mijë banorë dhe numri i shtretërve spitalorë publik dhe jopublik është 9.363 ose 3,3 shtretër për 1.000 banorë.


Tab. 5 Tregues të aktivitetit në institucionet publike të shërbimit spitalor

Treguesit e aktivitetit në Spitale Publike	Vitet				
	2017	2018	2019	2020	2021
Numri i institucioneve spitalore	42	42	42	42	43
Numri i shtretërve në total	8.169	8.185	8.189	8.334	8.501
Të shtruar në institucione	273.046	279.018	282.962	201.449	244.784
Ditë-shtretër të realizuar	1.444.336	1.528.499	1.491.930	1.032.922	1.248.197
Shfrytëzimi i shtratit në ditë	176,8	186,7	182,2	123,9	146,8
- në %	48,4	51,2	49,9	33,9	40,2
Ditë qëndrimi mesatar të sëmurit në spital	5,3	5,5	5,3	5,1	5,1
Xhiro e shtratit	33,4	34,1	34,6	24,2	28,8
Të sëmurë të operuar gjithsej	57.475	64.929	63.669	46.369	56.622

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Në institucionet publike të shërbimit spitalor, në vitin 2021 numri i të shtruarve është 244.784 pacientë. Ditët e qëndrimit mesatar të një pacienti janë 5,1 ditë në vit me një xhiro të shtratit 28,8 herë pacientë në vit. Shfrytëzimi i shtratit për kujdes shëndetësor gjatë vitit 2021 është 146,8 ditë, të cilat përbëjnë 40,2 % të ditëve kalendarike të këtij viti. Nga totali i pacientëve të shtruar, 23,1 % e tyre kanë kryer ndërhyrje kirurgjikale.

Fig. 2 Pacientë të shtruar dhe ditë mesatare të qëndrimit në institucionet publike të shërbimit spitalor



Metodologjia

Botimi “Treguesit e Shëndetit Publik” përmban të dhëna administrative mbi shërbimin e kujdesit shëndetësor parësor dhe shërbimin spitalor dytësor, me frekuencë vjetore. Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ndërkohë të dhënat mbi shërbimin vaksinal kanë burim informacioni Institutin e Shëndetit Publik.

Përkufizime

Qendrat e kujdesit shëndetësor parësor janë të gjitha institucionet shëndetësore që ofrojnë kujdes shëndetësor për pacientët në mënyrë ambulante, të cilat janë të pajisura me të paktën një personel mjekësor, mjek ose infermier (nuk përfshihet shërbimi i stomatologjisë).

Kujdesi shëndetësor parësor i ofrohet popullatës nga njësi bazë e tij, që njihet si Qendra shëndetësore kryesore, në nivel qyteti dhe qendër njësie administrative, dhe nga ambulance ose pika shëndetësore, në nivel fshati, duke synuar mbulimin sa më të gjerë dhe aksesin në shërbim shëndetësor të popullatës, si pika e parë e kontaktit me sistemin kombëtar të kujdesit shëndetësor.

Spitali është një rezidencë institucionale që ofron kujdes mjekësor, hoteleri-24 orë, diagnostikim, trajtim dhe rehabilitim të të sëmurëve që mund të kenë nevojë për ndihmë mjekësore ose kirurgjikale.

Shtretër spitalorë janë shtretër për akomodimin e pacientëve, të cilët janë pranuar formalisht në një institucion për trajtim ose kujdes, dhe që qëndrojnë minimumi një natë. Këtu përfshihen shtretër në të gjitha spitalet, përfshirë spitalet e përgjithshme, spitalet e shëndetit mendor dhe të abuzimit me substancat, spitalet e specialitetit, pavarësisht nëse krevati është i zënë apo jo.

Shfrytëzimi i shtratit në ditë është numri i ditëve mesatare të vitit gjatë të cilave një shtrat i spitalit është i zënë me pacientë.

Ditë shtretër të realizuar është shumëzimi i shfrytëzimit të shtratit në ditë me numrin e shtretërve në spital.

Shtrime spitalore është raporti i numrit të pacientëve të dalë nga spitalet në një vit me numrin e popullsisë së atij viti.

Xhiro e një shtrati është numri i të sëmurëve që janë shtruar në një shtrat gjatë vitit.